
Analiza për industrinë e letrës dhe kartonit



MAJ 2016

1. Hyrje

Në Kosovë, produktet e letrës dhe kartonit janë ndër produktet më të konsumuara nga amvisëria dhe bizneset, ndërsa prodhimi i tyre është shumë i vogël dhe nuk i përgjigjet kërkesës së madhe për këto produkte. Mungesa e ofertës nga prodhuesit vendor zëvendësohet me importin nga shtetet tjera, kryesisht shtetet fqinje. Letra e importuar përdoret edhe si lëndë e parë, që më vonë përpunohet për prodhim të kartonit dhe letrës higjienike.

Një nga kushtet paraprake për prodhimin e letrës dhe kartonit është posedimi i mjaftueshëm i drurit, si lëndë e parë, dhe makinerisë përpunuese. Kosova i plotëson këto kushte të nevojshme për prodhimin e letrës, mirëpo zhvillimi i kësaj industrie nuk ka treguar rezultate të kënaqshme që nga paslufta. Kjo diskrepancë në mes të ofertës, kushteve të pranishme në Kosovë për zhvillim të kësaj industrie, dhe kërkesës prej konsumatorëve, është problemi në të cilin është fokusuar kjo analizë.


Për vlerësimin e gjendjes së prodhuesve dhe përpunuesve të letrës dhe kartonit, ky studim është mbështetur në të dhënat e mbledhura prej intervistave me akterët kryesorë në këtë industri, ndërsa për vlerësimin e tregut janë përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës dhe Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK). Kjo analizë paraqet problemet më të mëdha që hasen në industrinë e letrës dhe kartonit dhe ofron rekomandime përkatëse për zgjidhjen e këtyre problemeve. Ndër problemet më të mëdha që janë identifikuar përmes kësaj analize janë konkurrenca e ulët dhe joefikasiteti, energjia elektrike, normat e larta të interesit, dyshimi për konkurrencë jolojale, mungesa e punëtorëve të kualifikuar dhe marketingu i pamjaftueshëm.

2. Tregu i letrës dhe kartonit në Kosovë

Në Kosovë, prodhimi dhe përpunimi i letrës dhe kartonit ndahet në dy fusha të gjëra: në atë të përpunimit të letrës higjienike dhe prodhimit dhe përpunimit të kartonit.

Përpunimi i letrës higjienike bëhet nga tri kompani të mëdha: Flutra, Mjellma dhe MDR Plast, siç mund të shihet në Figurën 1. Të tri këto kompani përpunojnë lëndën e parë që e importojnë nga Turqia, Greqia dhe vende të tjera të Evropës, në formë të fletëve të letrës. Më pas, këto fletë të letrës i shndërrojnë në letër higjienike. Kjo letër higjienike në procedura të mëtejshme ndahet në faculeta xhepi, letra kuzhine, letra toaleti dhe salveta. Produktet finale të përpunuara nga këto kompani më shumë koncentrohen në Kosovë, e në sasi më të vogla eksportohen jashtë vendit sikurse në Zvicër e në Shqipëri (në rastin e kompanisë Flutra). Përveç lëndës së parë, në tregun tonë importohen edhe produkte finale të letrave higjienike nga biznese të ndryshme dhe më pas shiten tek shitësit me pakicë.

Figura 1. Pasqyrimi grafik i tregut të letrës




Lënda e parë përdoret edhe për përpunimin dhe prodhimin e kartonit në Kosovë. Në Kosovë, prej dy llojeve të kartonit, atij të valëzuar dhe kromo-kartonit, prodhohet vetëm kartoni i valëzuar. Ekziston një prodhues me një traditë më të gjatë - Kosovapack, dhe një prodhues i ri që ka filluar punën në shkurt 2016 - Kemapack. Të

dy këto kompani e importojnë lëndën e parë në formë të fletës së letrës nga Kroacia, Serbia, Greqia dhe Turqia, dhe më pas prej saj e prodhojnë kartonin e valëzuar¹. Kosovapack prodhon tre lloje të kartonit: mikrovalë, treshtresor dhe pesështresor².

Gjatë hulumtimit tonë kemi arritur t'i identifikojmë gjithsej tetë përpunues të kartonit. Dy kompanitë e lartë-përmendura, Kosovapack dhe Kemapack, përpos prodhimit e bëjnë edhe përpunimin. Të tjera kompani në këtë fushë të veprimtarisë së përpunimit janë: Bigpack, Bujanipack, Dinapack, Semirpack, Erispack, Europack, Eserpack, Starpack. Shumë nga këto kompani punojnë me të tre llojet e lartë përmendura të kartonit të valëzuar si dhe furnizohen pjesërisht nga Kosovapack-u dhe pjesërisht nga kompani jashtë vendit siç shihet në Figurën 2. Më pas, kompanitë e përpunimit të kartonit furnizojnë bizneset vendore të cilat bëjnë ambalazhimin e produkteve të tyre. Vendet prej të cilave importohet lënda e parë për përpunim janë Maqedonia dhe Shqipëria, por edhe Italia, Kroacia edhe Serbia. Eksporti prej përpunuesve të kartonit është shumë i kufizuar. Vetëm një kompani - Semirpack, eksporton në Shqipëri, dhe vetëm një kompani - Bujanipack, eksporton në Zvicër dhe Belgjikë.

Figura 2. Pasqyrimi grafik i të tregut të kartonit



¹ Intervistë me Tafil Kalimashin, pronar i kompanisë Kosovapack, 15 shkurt 2016, Rahovec.


² Të njëjtat lloje do të prodhohen edhe prej Kemapack-ut.

Produktet kryesore të prodhuara nga përpunuesit e kartonit janë kutia për bartjen dhe transportin e lëngjeve, produkteve të qumështit, produkteve të mishit, si dhe për pemë e perime. Produkti më i shpeshtë është kartoni i picave. Kemapack bën edhe prodhimin e kartonave për mobilje, kurse Bigpack bën prodhimin e qeseve të letrës dhe gotave të letrës për kafe.

3. Importi dhe prodhimi vendor

Në vitin 2014, në Kosovë u importua letër dhe karton me vlerë prej 31.4 milionë euro, ndërsa u eksportuan produkte të ngjashme me vlerë 698,869 euro. Deficiti tregtar është thelluar që nga viti 2011, ndërsa tani është mbi 30 milionë euro.

Figura 3. Bilanci tregtar i prodhimeve të letrës dhe kartonit



Burimi: Dogana e Kosovës (2016).

Importi i lartë i letrës dhe kartonit është një nga faktorët më të mëdhenj në nivelin e deficitit tregtar vendor. Ky import vazhdon të thellohet për kundër faktit që kompanitë vendore posedojnë kapacitet të mjaftueshëm për të mbuluar një pjesë të madhe të tregut të brendshëm. Tabela 1 paraqet disa karakteristika të prodhueseve dhe përpunuesve më të mëdhenj në sektorin e letrës dhe kartonit.

Tabela 1. Prodhimi dhe përpunimi i letrës dhe kartonit, dhe shfrytëzimi i kapaciteti të disa prej kompanive më të mëdha vendore në këtë sektor

Kompania	Nr. i Punëtoreve Gra Burra	Mesatarja e prodhimit vjetor	Kapacitetet në vjet ne ton	Shfrytëzimi i kapacitetit
Kema Pack	0 8	2,555 ton	7,300 ton	35%
Kosova Pack	3 15	600 ton	2000 ton	30%
Bujani Pack	2 6	18 ton	90 ton	20%
Big Pack	0 6	/	/	50%
Semir Pack	0 14	/	/	100%
Eris Pack	2 2	600,000 cm ²	840,000 cm ²	71%
Mjellma	1 10	28.3 ton	94.3 ton	30%
Flutra	30	/	/	30%

Burimi: Instituti GAP (2015).

Dy kompanitë në prodhimin e kartonit shfrytëzojnë mesatarisht 33% të kapacitetit prodhues, kompanitë e përpunimit të kartonit 60%, ndërsa përpunuesit e letrës higjienike shfrytëzojnë mesatarisht vetëm 30% të kapacitetit. Përveç kapacitetit të pashfrytëzuar dhe varësisë në importin e këtyre produkteve, prodhimi i pamjaftueshëm i letrës paraqet probleme të mëdha edhe për operimin e disa bizneseve në Kosovë, të cilat detyrohen të importojnë letrën si lëndë për ambalazhim nga vendet fqinje dhe kështu përballen me vonesa të shumta në doganë.

Prandaj, duke marrë parasysh që prodhimet e letrës dhe kartonit kanë një përdorim mjaft të gjerë në Kosovë, ndërsa ka shumë pak prodhim, më poshtë kemi analizuar problemet kryesore që po e pengojnë rritjen e kësaj industrie.


4. Vështirësitë e prodhuesve dhe përpunuesve të letrës

4.1 Konkurrenca e ulët dhe joefikasiteti

Një ndër problemet kryesore në tregun e prodhimit të kartonit është konkurrenca e ulët dhe joefikasiteti në prodhim. Dy ndërmarrjet e vetme në Kosovë të cilat bëjnë prodhimin e kartonit, nuk po arrijnë të jenë konkurrenca me kompanitë rajonale në çmim. Edhe pse

gëzojnë fuqinë punëtore ndër më të lirën në rajon, ato nuk po arrijnë të ofrojnë çmim më të lirë se kompanitë rajonale. Në Tabelën 3, është paraqitur mesatarja e çmimit të kartonit në kompanitë kryesore të prodhimit të kartonit në Kosovë dhe rajon.

Tabela 3. Çmimet mesatare të prodhuesve të kartonit në Kosovë dhe rajon



Burimi: Instituti GAP (2015).

Nga tabela më lartë shihet se në dy kategoritë e prodhimit të kartonit, kompanitë kosovare dalin me çmim më të lartë se ato në rajon. Përpunuesit vendor, të cilët furnizohen me karton nga prodhues të ndryshëm, deklarojnë se çmimi i lartë i prodhimit vendor i shtyn ata që shpesh herë të importojnë kartonin nga Maqedonia, Shqipëria e vende të tjera rajonale. Madje ata deklarojnë se edhe pas shpenzimeve të transportit dhe vonesave doganore, çmimi i kartonit të importuar është më i lirë se ai i prodhuar në Kosovë.

Çmimi i lartë i prodhimit vendor të kartonit mund të jetë rezultat edhe i konkurrencës së kufizuar. Deri në shkurt të vitit 2016, në Kosovë ka operuar vetëm kompania Kosovapack e cila bën prodhimin e kartonit të valëzuar. Çmimi mesatar i kartonit treshtresor dhe pesështresor i kësaj kompanie është 35 cent dhe 45 cent respektivisht, ose mesatarisht 52% më i shtrenjtë se i prodhuesit nga Maqedonia. Megjithatë, nga fillimi i vitit 2016, në Kosovë ka filluar punën edhe kompania Kemapack e cila prodhon të njëjtat produkte me një çmim më të konkurrueshëm. Hyrja e kompanisë së dytë në prodhimin e kartonit ka ulur çmimin mesatar,

mirëpo prapë të dy kompanitë vendore kanë çmim më të lartë se kompanitë në rajon. Çmimi i lartë i prodhimit të kartonit në mënyrë zingjirore i bën jokonkurrent edhe përpunuesit e kartonit si dhe bizneset vendore të cilat ambalazhojnë produktet e tyre të prodhuesit apo përpunuesit vendor.

Në anën tjetër, një konkurrencë më e lartë ekziston tek përpunimi i letrës higjienike. Aktualisht në Kosovë janë tri kompani të mëdha të cilat përmes lëndës së parë të importuar bëjnë përpunimin e produkteve të letrave higjienike. Këto kompani deklarojnë që çmimi i përpunimit ka një kosto të konkurrueshme me produktet e letrës higjienike të importuar.

4.1 Normat e larta të interesit

Një nga barrierat kryesore për hyrjen e kompanive tjera në prodhimin e kartonit është teknologjia e shtrenjtë, financimi i të cilës vështirësohet nga normat e larta të interesit dhe mungesa e granteve shtetërore për këtë industri.

Në anketën e zhvilluar nga Instituti GAP me bizneset vendore, disa prej prodhuesve kanë treguar se kanë marrë oferta për të eksportuar në rast se do të kishin teknologji më të avancuar. Mirëpo, normat e larta të interesit kanë bërë që investimet e reja të mos jenë të leverdishme dhe rrjedhimisht është humbur edhe mundësia për eksport. Këto norma vazhdojnë të jenë të larta përkundër faktit që kreditë jo performuese në Kosovë u zvogëluan për 5% nga viti 2013 në vitin 2014 dhe qëndrojnë ndër më të ulëtat në rajon³.

Përveç humbjes së mundësisë së eksportit, normat në kredi po ndikojnë keq edhe në konkurrueshmërinë e këtyre kompanive brenda vendit. Sipas përpunuesve, nëse do të fillonin të bënin edhe prodhimin e kartonit, me normat aktuale, produkti i tyre i letrës do të dilte me çmim më të lartë se sa produktet që sillen nga Serbia.

Për këtë mungesë të investimeve, prodhuesit dhe përpunuesit e kartonit fajësojnë edhe qeverinë e cila përveç lirimit të tatimit në import të makinerisë prodhuese, nuk ka ofruar ndonjë skemë

³ Banka Qendrore e Kosovës, Raporti Vjetor 2014, qasur më 04.04.2016, <http://bit.ly/1UCGB6z>

mbështetëse të granteve për sektorin e letrës dhe kartonit. Mungesa e granteve po konsiderohet nga bizneset e këtij sektori si humbje e mundësisë që Kosova të shfrytëzojë potencialin në zëvendësimin e importit dhe krahas ngritjes së prodhimit të eksportojë dhe punësojë një numër të madh të njerëzve.


4.2 Energjia elektrike

Energjia elektrike vazhdon të paraqes problem serioz edhe në konkurrueshmërinë e sektorit të letrës dhe kartonit, e edhe në operimin e rregullt të saj. Prej shtatë kompanive të intervistuar që punojnë në këtë sektor, gjashtë u deklaruan që kanë problem me energjinë elektrike. Kompanitë vendore deklarojnë se problemet kryesore janë çmimi i lartë i energjisë elektrike dhe ndërprerjet e paparalajmëruara.

Disa prej këtyre kompanive ankohen se çmimi i lartë i energjisë elektrike bën që një pjesë e konsiderueshme e fitimeve të shkojë për pagesë të energjisë. Ky shpenzim vështirëson edhe më shumë gjendjen financiare dhe afariste të prodhuesve vendor kur shohim se çmimi i energjisë elektrike për industri është më i lartë në Kosovë se në disa vende të rajonit të cilat konkurrojnë drejtpërdrejt me produktet kosovare. Serbia, si një nga shtetet më konkurrencte me Kosovën, ka çmimin e energjisë elektrike për industri mesatarisht 45% më të ulët⁴. Me çmim më të lirë është edhe Bosnja dhe Hercegovina dhe disa vende të tjera të cilat paraqesin pengesë në konkurrueshmërinë e prodhimit vendor, ngase çmimi i energjisë elektrike reflektohet në çmimet e produkteve finale. Kjo dëmton investimet e kompanive vendore dhe kufizon punësimin e një numri më të madh të qytetarëve.

Problemet tjera me energjinë elektrike kanë të bëjnë me ndërprerjet e paparalajmëruara që ndodhin tek industritë që janë pjesë e grupit A+. Këto ndërprerje iu kushtojnë ndërmarrjeve jo vetëm me orë të humbura të prodhimit, por edhe me humbje të materialit që shkaktohet me çdo ndërprerje të energjisë elektrike. Sipas kompanisë Kosovapack, pas çdo ndërprerje të energjisë elektrike, kompania duhet të ri-ngroh kaldajat e prodhimit të kartonit të cilat shpenzojnë shumë energji, si dhe duhet ta hedhë tërësisht

⁴ Çmimi për tension 10kV



materialin i cili mbetet në proces të prodhimi. Këto dy shpenzime që shkaktohen nga secila ndërprerje, rrisin barrën financiare të kompanive në këtë sektor. Prandaj, si rezultat i çmimit të lartë të energjisë elektrike si dhe ndërprerjeve të paparalajmëruara, çmimi final i produkteve të kartonit vazhdon të mos jetë konkurrent me çmimet e prodhuesve të rajonit.

4.3 Konkurrenca jolojale


Problem tjetër i ngritur nga pothuajse të gjithë prodhuesit dhe përpunuesit në sektorin e letrës dhe kartonit janë dyshimet për import të pakontrolluar. Ky import i pakontrolluar, që do të thotë shmangie e pagesave doganore, kontribuon që çmimet e letrës dhe kartonit të cilat dalin në treg të jenë më të ulëta se sa çmimet e produkteve vendore. Pra, kjo konkurrencë jolojale bën që produktet vendore të mos konsumohen aq sa ato që dyshohet se hynë në mënyrë të pakontrolluar në territorin e Kosovës.

Ndonëse këtu bëhet fjalë për margjinë shumë të vogël të dallimit në çmim, diku rreth 1 ose 2 centë, kur konsiderohet se këto produkte shiten dhe blihen me sasi shumë të lartë, atëherë dallimi bëhet i konsiderueshëm.

Kompanitë që prodhojnë letër higjienike dhe produkte të tjera vlerësojnë se kanë pasur trefish më shumë shitje në periudhën e vitit të kaluar kur u zbatua reciprociteti në tregti me Serbinë dhe u ndal importi.

4.4 Mungesa e punëtorëve të kualifikuar

Katër prej shtatë prodhuesve dhe përpunuesve deklarojnë se problem në zhvillim të ndërmarrjes së tyre është edhe mungesa e punëtorëve të kualifikuar për profesione, si: mirëmbajtës të makinerisë, teknologë, dhe grafistë për shtyp. Kompanitë në këtë industri tregojnë se ka pasur raste kur është dashur të thirren profesionistë të këtyre fushave nga Turqia dhe vendet e tjera për mirëmbajtje të makinerisë, paga e të cilëve ka kaluar dy herë pagën mesatare në Kosovë, për shkak të mungesës së mirëmbajtësve të makinerisë në Kosovë.



Për më shumë, të gjithë të intervistuarit kanë treguar se për secilin punëtor është dashur të mbahet trajnim fillestar për shkak të mungesës së aftësive, edhe kur vendi i punës është bazuar në aftësi minimale teknike.

Madje, mungesa e punëtorëve të kualifikuar ndikon negativisht edhe në investime në teknologji të reja, pasi që kompanitë e dinë që në rast se sjellin investime të reja duhet të sigurojnë edhe fuqinë punëtore të aftë për të punuar me atë teknologji si dhe për ta mirëmbajtur atë.

4.5 Promovimi i prodhimeve vendore

Probleme tjera që i hasin kompanitë kanë të bëjnë me mungesën e promovimit të produkteve si përmes panairove ashtu edhe përmes investimit në marketing. Panairët janë konsideruar prej prodhuesve dhe përpunuesve të letrës si shumë të nevojshme për gjetjen e partnerëve. Të tilla panairë, që fokusin e kanë tek prodhuesit e letrës, nuk janë organizuar ndonjëherë në Kosovë. Kjo i ka lënë prodhuesit e letrës me mungesë të informacioneve për bizneset vendore me të cilat mund të bashkëpunojnë. Mungesa e informacionit është një nga faktorët që shpjegon se pse ka preferencë për produkte të jashtme karshi atyre vendoreve në këtë sektor. Sektori i përpunimit dhe prodhimit të letrës është shumë pak i njohur në Kosovë. Për këtë arsye, ndërmarrjet kërkojnë promovimin e sektorit prej qeverisë në mënyrë që të dihet se edhe në Kosovë ka produkte të tilla që ofrohen.

Po ashtu, në këtë sektor vlerësohet se shumë pak është investuar edhe individualisht në krijimin e kontakteve me prodhues të produkteve të tjera të cilët kane nevojë për ambalazhim.

5. Përfundime dhe rekomandime

Në këtë analizë është paraqitur gjendja e përpunuesve të letrave higjienike dhe prodhuesve dhe përpunuesve të kartonit. Si përfundim del se Kosova ka një përdorim mjaft të lartë të letrës dhe kartonit dhe bazuar në ngritjen e prodhimit vendor, parashihet edhe një ngritje e nevojës për këto produkte.

Në Kosovë ekziston një hendek mjaft i lartë në mes të ofertës dhe kërkesës. Në vitin 2015, importi i produkteve të letrës dhe kartonit ka arritur në 31 milionë euro duke shënuar vlerën më të lartë të importuar që nga viti 2011. Ky import u realizua përkundër faktit që kapacitetit vendor i prodhimit u shfrytëzua mesatarisht vetëm 48%.

Sipas bizneseve vendore del se problemet kryesore që pengojnë rritjen e industrisë së letrës dhe kartonit janë: konkurrenca e ulët dhe joefikasiteti në prodhim, normat e larta të interesit, mungesa e energjisë elektrike dhe çmimi i lartë i saj, dyshime për konkurrence jolojale, mungesa e kuadrit profesional, dhe marketingu i pamjaftueshëm.

Instituti GAP beson se zhvillimi i kësaj industrie paraqet mundësi reale të përmirësimit të bilancit tregtar dhe krijon mundësi punësimi për një numër të madh të qytetarëve. Andaj, Instituti GAP ofron këto rekomandime që mund të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes aktuale në këtë sektor.

Për Kompaninë e Furnizimit me Energji Elektrike (KESCO):

- Të bëjë lajmërimin e rregullt të konsumatorëve të kategorisë A+ përmes telefonit dhe postës elektronike për ndërprerje të energjisë elektrike, si dhe të zgjerojë numrin e bizneseve prodhuese dhe përpunuese në këtë kategori ngase për çdo ndërprerje shkaktohen humbje të mëdha në prodhim;

Për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë:

- Në shqyrtimin e dhjetë tarifor të shikojë mundësinë e uljes së çmimit të energjisë elektrike për kategorinë e tarifave

industriale (10kV) ngase prodhuesit industrial nuk po mund të jenë konkurrent me prodhuesit e rajonit;

Për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë:

- Të fillojë një hetimin preliminar për kompanitë të cilat dyshohen se janë duke bërë dumping;
- Të tregohet vigjilente sidomos kur ka teprica në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare të produkteve ngase në raste të tilla ka tendenca të dampingut dhe të dëmtimit të prodhimit vendor;
- Të shqyrtojë mundësinë e ndarjes së granteve në modernizimin e makinerisë së letrës dhe kartonit ngase është një treg i madh dhe me mundësi reale të zëvendësimit të importit dhe të ngritjes së punësimit;
- Të mundësojë organizimin e panaireve që kanë për qëllim lidhjen e prodhuesve dhe përpunuesve të kartonit me bizneset prodhuese në Kosovë të cilat kanë nevojë për ambalazhim të produkteve të tyre;

Për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale:

- Të bashkëpunojë me bizneset vendore në përcaktimin e mungesës se kuadrit profesional dhe rrjedhimisht të fillojë trajnime të ndryshme në ato fusha;

Për kompanitë e prodhimit të kartonit:

- Të shikojnë mundësinë e ristrukturimit të ndërmarrjes në mënyrë që të krijohen hapësira për uljen e çmimit të kartonit dhe të përfitojnë tregun vendor;
- Të investojnë në marketing që t'i informojnë përpunuesit dhe prodhuesit vendor që mund të bëjnë ambalazhimin e produkteve të tyre;
- Të shikojnë mundësinë e përfitimit të kredive me norma më të ulëta të interesit nën Fondin Kosovar për Garanci Kreditore

Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:

